

THIRRJE PËR APLIKIM PROJEKTESH

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, në përmbushje të objektivave, funksioneve dhe kompetencave sipas kërkesave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për periudhën 2017-2019; si dhe në kuadër të 20 vjetorit të institucionit shpall Thirrjen për Aplikime Projektsh për ato institucione dhe organizata, të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias.

Ato subjekte që janë të interesuara në komponentët dhe aspektet e mëposhtme, ftohen që, brenda datës 08.02.2019, ora 11.00, të paraqesin dorazi, në zyrën e protokollit të AMA-s propozimin për projekt e fokusuar në:

Komponenti i parë: Kryerja e studimeve dhe analizave mbi tregun audioviziv shqiptar.
Komponenti i dytë: Përkthime në gjuhën shqipe dhe publikimin e tyre nga literatura e fushës së mediave audiovizive.

1. Për komponentin “Kryerja e studimeve dhe analizave mbi tregun audioviziv shqiptar”, qëllimi dhe synimi është për të ftuar në aplikim subjekte të interesuara për:

1.1 Realizimin e një studimi dhe analize të performancës në tregun audioviziv shqiptar, vlerësimeve të ndjekësve të përmbajtjeve të transmetuara, përfshirë dhe publikimin (me ISBN), si dhe organizimin e një konference ndërkombëtare, fokusuar në njërin prej dy aspekteve të mëposhtme:

- a. Fluksi i përmbajtjeve audiovizive, nevojat e informimit të publikut, roli dhe sfidat e autoritetit rregullator.
- b. Fëmijët dhe edukimi mediatik.

1.2 Realizimin e një studimi dhe analize të performancës në tregun audioviziv shqiptar, vlerësimeve të ndjekësve të përmbajtjeve të transmetuara, përfshirë dhe publikimin (me ISBN), fokusuar në njërin prej dy aspekteve të mëposhtme:

- c. Respektimi i standardeve të shqipes së shkruar dhe të folur në transmetimet audiovizive.
- d. Evitimi i diskriminimit me bazë gjinore dhe dhunës së çdo forme ndaj femrave.

1.3 Realizimin e një studimi e analize, duke përfshirë dhe publikimin (me ISBN), mbi kuadrin aktual ligjor dhe nënligjor shqiptar për median audiovizive, si dhe opsionet e përshtatjes e reflektimit në të, të ndryshimeve më të fundit të direktivës evropiane për shërbimet audiovizive.

1.4 Realizimin e një studimi e analize, duke përfshirë dhe publikimin me ISBN, mbi kujtesën dhe interpretimin e krimeve të periudhës së diktaturës komuniste në programet audiovizive.

2. Për komponentin e dytë: “Përkthime në gjuhën shqipe dhe publikimin e tyre nga literatura e fushës së mediave audiovizive”, qëllimi dhe synimi është për të ftuar në aplikim ato subjekte që kontribuojnë në pasurimin e bibliotekës së grupeve të interesit në sektorin mediatik,

veçanërisht redaksive audiovizive, si dhe studentëve e kërkuesve të fushës dhe ku aplikuesi siguron vetë sipas legjislacionit në fuqi dhe garanton të drejtat përkatëse autoriale.

Për të gjithë të interesuarit aplikimi, detyrimisht, përshtatet në përmbajtje sipas modelit të formularit që gjendet në faqen online të AMA-s, www.ama.gov.al (Formular për Aplikim Projekt) duke plotësuar çdo kërkesë të tij. Aplikanti duhet të shprehet që në fillim për aspektin për të cilin ka interes, duke e cituar të plotë njërin prej aspekteve të shpjeguar më sipër.

Më shumë informacion për procesin e aplikimit gjeni në udhëzimin përkatës (Udhëzim për Aplikim), i cili po ashtu gjendet në faqen online të institucionit.

Në planin buxhetor të projektit të propozuar, vetë aplikuesi, detyrimisht duhet të ketë të pasqyruar një angazhim vetëfinansues jo më pak se 25% të vlerës totale të buxhetit.

Subjekteve të interesuara, të cilat nuk respektojnë afatin kohor të dorëzimit në protokollin e AMA-s të aplikimit nuk ju merret në dorëzim dokumentacioni.

Subjekteve e interesuara, që nuk kanë plotësuar të gjitha kërkesat e formularit, apo janë jashtë fokusit të komponentëve dhe aspekteve të shpjeguara më sipër, do të konsiderohen të skualifikuara.

Projektet duhet të hartohen dhe planifikohen nga aplikuesit në mënyrë që finalizimi i tyre me produkte, evente, si dhe dorëzimi i të gjithë dosjes së dokumentacionit të bëhet brenda datës 27.11. 2019, ora 11.00.

AMA do të vijojë komunikimin dhe procedimin e mëtejshëm vetëm me ata aplikues të cilëve iu vlerësohet projekti në përputhje me kërkesat e kësaj Thirrjeje.

Autoriteti i Mediave Audiovizive

Tiranë më 8 Janar 2019